

Mësimi Digjital: Mësimdhënia online në nivelin e duhur

90 mësimdhënës nga shkollat profesionale dhe ato të mesme të larta nga 22 komuna të Kosovës janë trajnuar në fushën e Mësimdhënies Online, si një qasje inovative dhe pjesë e agjendës së digjitalizimit si të Kosovës, ashtu edhe të Qeverisë Gjermane.

Programi i trajnimit për Mësimdhënien Online është zhvilluar nga KCDE me mbështetjen e GIZ Kosova. Ky trajnim synon të kontribuojë në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve dhe si i tillë është akredituar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)